

VENDIM
Nr.441, datë 13.7.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.370, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE
TË NËPUNËSVE TË ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.370, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“1. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme të jenë:
 - a) Prefekt i qarkut Tiranë 110 000 lekë;
 - b) Prefekt i qarqeve të tjera 102 000 lekë;
 - c) Nënprefekt i nënprefekturave Kavajë dhe Lushnjë 87 000 lekë;
 - ç) Nënprefekt në nënprefekturat Krujë, Pogradec, Librazhd, Tepelenë, Përmet, Mat, Sarandë, Pukë, Tropojë dhe Skrapar 81 000 lekë;
 - d) Nënprefekt në nënprefekturat Malësi e Madhe, Bulqizë, Peqin, Gramsh, Devoll, Mallakastër, Has, Kuçovë, Mirditë, Delvinë, Kurbin dhe Kolonjë 74 000 lekë;
 - dh) Këshilltar i prefektit të Tiranës 57 000 lekë;
 - e) Zëdhënës i prefektit të Tiranës 47 000 lekë.”.
 - b) Lidhja nr.1 e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Efektet financiare për vitin 2007 që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave, sipas ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR. 1

EMERTIMI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHITESA E POZICIONIT
		1	2	3	
		Paga e Grupit (PG) leke	Shtesa Vjetore per Vjetersi (SHV) perqindje	Shtesa per Kualifikim (SHK) leke	Shtesa per Pozicion (SHP) leke
Sekretar i Pergjithshem ne Prefekturë.	III-a	10.050	2%	0	65.000
Sekretar i Pergjithshem ne Nenprefekturat Kavaje dhe Lushnje.	III-a/1	10.050	2%	0	55.000
Pergjegjes Saktori ne Prefekturë.	III-b	10.050	2%	0	49.000
	IV-a	10.050	2%	0	37.450
Pergjegjes Zyre ne prefekturë. Pergjegjes Zyre ne nenprefekturë	IV-a	10.050	2%	0	37.450
Pergjegjes Saktori ne Nenprefekturë. Inspektori auditit ne Prefekturë.	IV-a	10.050	2%	0	37.450
Specialist ne Prefekturë.	IV-b	10.050	2%	0	25.850
	IV-c	10.050	2%	0	19.900
Specialist ne Nenprefekturë.	IV-c	10.050	2%	0	19.900
Sekretar.	IV-c	10.050	2%	0	19.900